

Dialogu Beograd-Prishtinë dhe Veriu i Kosovës

Hyrje

Këshilli për Qeverisje Inkluzive (CIG) ka organizuar më 22-23 mars të vitit 2013 në Stamboll të Turqisë, tryezën e pestë të rrumbullakët për përfaqësuesit e partive politike dhe shoqërisë civile nga Kosova e Serbia për kërkimin e zgjidhjeve për veriuin e Kosovës. Pjesëmarrësit nga Kosova kanë qenë zytarë nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Partia e Pavarur Liberale (SLS), Lista e Bashkuar Serbe (JSL), zyra e kryeministrit dhe presidentit, dhe nga Serbia, Partia Progressive Serbe (SNS), Partia Socialiste e Serbisë (SPS), Rajonet e Bashkuara të Serbisë (URS), Partia Liberal Demokrate (LDP), qeveria dhe zyra e presidentit, dhe një numër i analistëve nga Serbia dhe Kosova. Në takim kanë marrë pjesë poashtu edhe diplomatë evropianë e amerikanë.

Tryeza është pjesë e projektit mbi veriuin e Kosovës i financuar nga Departamenti Federal Zvicrran i Punëve të Jashtme.

Në ditën e parë, CIG ka organizuar një tryezë që ka përfshirë gjashtë analistë nga Kosova e Serbia. Ata kanë diskutuar dialogun e sponzorizuar nga BE-ja mes kryeministrave të Kosovës dhe Serbisë, të përshkruajnë sfidat e mundshme në procesin e implementimit dhe të japin një numër rekomandimesh për të adresuar këto sfida. Analistët kanë dhënë rekomandime në katër fusha: natyrën e marrëveshjes së ardhshme, influencën e partive politike në suksesin e zbatimit, rolin e popullatës serbe në veri të Kosovës në fazën e implementimit, si dhe periudhën kalimtare. Këto rekomandime janë diskutuar nga një grup më i gjërë gjatë diskutimit në ditën e dytë. Edhe pse pjesëmarrësit kanë pasë qëndrime të ndryshme rreth mënyrës se si do të dukej një zgjidhje gjithëpërfshirëse për veriuin, ata kanë propozuar një numër hapash për përmirësimin e cilësisë së dialogut të tanishëm dhe rezultateve të tij, si dhe për zbatimin e marrëveshjeve të ardhshme. Ata i kanë rekomanduar Beogradit e Prishtinës që ta informojnë më mirë publikun e tyre rreth dialogut, marrëveshjeve, përparësitë e dobësitë e tyre dhe të eliminojnë interpretimet kundërshtuese, të prodhojnë marrëveshje më të qarta me përfitime të prekshme për popullatën si dhe të fillojnë përgatitjet për periudhën e tranzicionit.

Në vazhdim është një përmbledhje e diskutimeve të tryezës. Me qëllim të inkurajimit të diskutimit të hapur, fjalimet nuk u janë atribuar diskutuesve specifik dhe CIG kërkon mirëkuptimin e atyre fjalimet e të cilëve nuk janë përfshirë tërësisht në këtë raport të shkurtër. Pjesëmarrësit kanë marrë pjesë në tryezë në kapacitetin e tyre personal dhe mendimet e tyre nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e organizatave të cilat ata përfaqësojnë. Pjesëmarrësit nuk e kanë e kanë parë këtë raport dhe CIG bartë përgjegjësinë për përmbajtjen e tij.

Dialogu dhe veriu i Kosovës

Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve ishin të sigurtë se një marrëveshje gjithëpërfshirëse do të arrihej mes Prishtinës e Beogradit. Ata kanë thënë se është e rëndësishme që njerëzit ta dinë se për çfarë shërbejnë këto marrëveshje dhe të jepen detaje të mjaftueshme për të treguar benefitet që do t'i merrnin njerëzit në veri të Kosovës. Serbët në veri duhet ta shohin se marrëveshjet do të kenë efekt të drejtpërdrejt pozitiv në jetërat e tyre dhe se kushtet e tyre të jetesës do të përmirësohen gradualisht, edhe pse ata mund të humbin disa nga benefitet e tanishme. Shumë pjesëmarrës kanë thënë se marrëveshjet duhet të kenë edhe afate dhe orare të zbatimit. Përparimi eventual në veri nuk do ta stabilizojnë gjendjen vetëm atje, por do ta relaksojë gjendjen e përgjithshme ndëretnike në Kosovë, dhe do të përmirësojë marrëdhëniet mes Beogradit e Prishtinës. Arsyeja pse pjesëmarrësit kanë besuar se marrëveshja është shumë afër është sepse shumë prej tyre kanë menduar se palët nuk kanë shumë opsione dhe besojnë se më vonë nuk do të mund të marrin atë që iu ofrohet sot. Por, sipas një numri të pjesëmarrësve, komuniteti ndërkombëtar duhet të jetë i kujdesshëm dhe të sigurohet që dialogu të mos ketë humbës, ku secili duhet të heq dorë nga diçka por edhe të përfitojë nga marrëveshjet.

Disa pjesëmarrës kanë parashikuar se zbatimi i marrëveshjeve do të jetë edhe më i vështirë se procesi i arritjes së marrëveshjeve. Shumë probleme do të dalin në sipërfaqe, dhe disa prej pjesëmarrësve ishin skeptik nëse marrëveshjet do të zbatoheshin. Si Prishtina ashtu edhe Beogradi kanë zvarritur implementimin e marrëveshjeve të kaluara. Një folës ka thënë se Prishtina nuk ka qenë shumë e zoja në implementimin e planit të Ahtisaarit në tërësi as në jug. “Caktimi i shefave të policisë nga autoritetet lokale dhe vendosja e gjykatave lokale nuk janë implementuar ende. As ligji për gjuhët nuk është respektuar në tërësi”. Ky folës ka shtuar se ligjet janë moderne në letër por se procesi i implementimit ka mbetur prapa. Përderisa Prishtina mund t'i ngadalësojë pjesët e marrëveshjeve që nuk i pëlqejnë, Beogradi do ta kishte mjaft të vështirë t'u shpjegontë serbëve në veri benefitet e marrëveshjeve si dhe t'i bindte ata që mos ta pengojnë procesin. Shumë folës kanë thënë se Beogradi është faktori kryesor në raport me serbët në veri dhe se ndikimi i tij është kyç në procesin e implementimit.

Megjithatë, një numër i folësve shqiptarë të Kosovës kanë thënë se Beogradi nuk duhet të jetë shumë i përfshirë në zbatimin e marrëveshjeve në territorin e Kosovës dhe se institucionet e Kosovës dhe serbët në veri duhet të jenë akterët kryesor implementues. Ata kanë thënë se serbët në veri duhet të përfshihen më shumë, por kanë qenë shumë të qartë në kundërshtimin e përfshirjes së udhëheqësve të institucioneve serbe në atë pjesë, në procesin e implementimit. Ata kanë refuzuar propozimet e pjesëmarrësve tjerë për legalizimin e institucioneve lokale serbe në veri. “Serbët duhet ta pranojnë realitetin e ri në Kosovë dhe askush nuk duhet të manipulojë me ndjenjat e serbëve. Sigurisht se Beogradi ka të drejtë të interesohet për serbët në Kosovës, por qeveria e Kosovës është ajo që udhëheq”, ka thënë një folës. Një serb nga veriu ka thënë se “as Beogradi, e as Prishtina, por serbët në veri duhet të jenë akteri kryesor në procesin e implementimit”. Një numër i pjesëmarrësve kanë thënë se nëse nuk arrihet një marrëveshje deri në muajin prill, dialogu “nuk duhet të deklarohet i vdekur”.

Një folës serb ka thënë se të drejtat e serbëve në jug nuk duhet të zvogëlohen, pavarësisht natyrës së marrëveshjes së arritur për veriu. Ai ka kërkuar më shumë sqarime nga Prishtina e Beogradi, si dhe më shumë angazhim nga ana e Prishtinës për mosreduktimin e të drejtave të serbëve në jug,

nëse të drejta shtesë u jepen serbëve në veri. Ai ka sugjeruar që serbët në jug dhe ata në veri duhet të diskutojnë përvojat e tyre si dhe mënyrat në të cilat gjendja në veri mund të stabilizohet gradualisht.

Disa folës nga Kosova kanë pranuar se jo të gjitha ligjet e Kosovës implementohen, “por jo vetëm në pjesët serbe, por edhe në ato shqiptare”. Ky folës ka qenë fuqishëm kundër propozimit të ardhur nga takimi i analistëve i një dite më parë për vendosjen e një trupi të përbashkët implementues e koordinues me Serbinë. Ai ka argumentuar se Beogradi nuk duhet të përfshihet në implementimin e politikave në territorin e Kosovës, duke thënë se “nuk them se Beogradi nuk duhet të përfshihet fare, por nuk duhet të përfshihet shumë”.

Një folës i afërt me procesin e dialogut në Bruksel ka thënë se në teori duket mirë të kemi marrëveshje të detajuara, por kjo nuk funksionon në praktikë. Ai ka thënë se është më mirë të kemi marrëveshje të detajuara, porse është më e lehtë të merren marrëveshje të cilat janë të paqarta dhe siç duket kjo do të ndodhë edhe kësaj rradhe. Ai ka parashikuar se implementimi do të jetë i vështirë, me shumë interpretime, por ka thënë se “kjo është natyra e procesit”. Ai ka theksuar se afatet dhe oraret janë të mira por “kësaj rradhe ato nuk do të jenë strikte, sidomos pasi që nuk mund të japim dënime për mosimplementim”. “Ne mund ta shtyejme implementimin përpara edhe pas zvarritjes së procesit”.

Disa folës kanë thënë se marrëveshjet e arritura mes kryeministrave duhet të ratifikohen nga parlamentet e Kosovës dhe Serbisë me qëllim të moslënies së hapësirës për rinterpretim më vonë, posaçërisht në rast se ndodhin ndryshime në qeveritë e Prishtinës apo Beogradit. Për më shumë, ata poashtu kanë kërkuar që ekipet negociatore duhet t’i informojnë parlamentet e tyre në mënyrë më të rregullt. Edhe pse ratifikimi i marrëveshjeve nga parlamentet përkatëse do t’u jipte atyre legjitimitet, shumica e folësve kanë thënë se komuniteti ndërkombëtar është ende i nevojshëm si garantues në implementimin e marrëveshjeve. Një numër i pjesëmarrësve serbë kanë thënë se komuniteti ndërkombëtar duhet të jetë garantues i stabilitetit dhe sigurisë për të gjithë komunitetin serb në Kosovë.

Disa pjesëmarrës kanë vënë në pikëpyetje rolin e garantuesit. Një folës ka dashur të dijë rreth rolit eventual të garantuesit nëse serbët në veri rezistojnë në implementimin e marrëveshjeve. Ai ka rekomanduar që marrëveshje të jenë para së gjithash në pajtim me interesat e serbëve në veri. Një folës tjetër ka thënë se akterët kryesorë duhet t’i përfshijnë njerëzit në veri më shumë në këtë proces. “Askush nuk i pyet njerëzit në veri për asgjë; vetëm udhëheqësit lokal flasin tërë kohën, zëri i popullit nuk dëgjohet”. Një folës ka thënë se votuesit e tyre presin nga ta që ta mbrojnë kushtetutën dhe ligjet, por gjithashtu që të kuptojnë domosdoshmërinë dhe nevojën për të arritur kompromise. Ajo ka thënë se Prishtina duket më e interesuar në mbrojtjen e territorit, dhe jo aq shumë në mirëqenien e njerëzve që jetojnë atje.

Roli i partive politike në dialog është konsideruar si i rëndësishëm. Një folës nga Kosova ka thënë se partia e tij mbështet dialogun, por jo pa kushte. Një anëtar tjetër i një partie tjetër opozitare në Kosovë poashtu ka thënë se partia e tij e mbështet dialogun por vetëm përderisa marrëveshjet e arritura janë në pajtim me sistemin e Kosovës. Ai më tej ka kërkuar që të ketë më shumë sqarime rreth marrëveshjeve me qëllim të menjanimin të interpretimeve kundërshtuese. Ai ka thënë se qeveria e Kosovës duhet të bëjë më shumë aktivitete informuese në veri. “Qeveria

duhet të jetë e angazhuar në aktivitete informuese, në media, në shoqëri civile dhe me njerëzit e zakonshëm në veri”. Ai poashtu ka shtuar se është legjitime për Beogradin që të kujdeset për të ardhmen e serbëve në Kosovë.

Partitë politike në Serbi poashtu mbështesin dialogun. Disa folës, megjithatë, kanë thënë se SNS-ja duhe të jenë më e përfshirë në proces, përmes pjesëmarrjes së drejtpërdrejt të kryetarit të saj në dialog. Ata poashtu kanë thënë se partitë politike serbe, e sidomos ato në pushtet, SNS-ja dhe SPS-ja, duhet të përfshihen më shumë në veri me qëllimin për t’i bindur njerëzit atje për pranimin e marrëveshjeve.

Përgatitjet për tranzicion

Duke marrë parasysh se shumica e pjesëmarrësve kanë besuar se marrëveshja është e paevitueshme, një pjesë e diskutimeve i është dedikuar periudhës kalimtare. Shumë presin që do të ketë frustrim dhe pakënaqësi të shumta me marrëveshjet eventuale në veri. Edhe pse çështja kryesore do të jetë transformimi i institucioneve të tanishme në veri, debati është fokusuar më shumë në propozimin e asociacionit të komunave dhe nëse ky asociacion do të duhej të kishte fuqi legislative dhe ekzekutive.

Një folës ka thënë se asociacioni i komunave duhet të ketë të drejtën e bashkëpunimit ndërkufitar dhe se zgjedhjet duhet të jenë pjesë e marrëveshjes së përgjithshme, e jo të organizohen zgjedhje pa pasë një plan të qartë për periudhën pas tyre. Zgjedhjet duhet të vijnë të parat, e pastaj asociacioni i komunave. Kryetarët e rinjë të komunave duhet të jenë të angazhuar qartë në implementimin e marrëveshjeve.

Disa nga pjesëmarrësit kanë pyetur se si do të shkonte procesi në rast të dhunës në veri. “Ne zakonisht harrojmë se çka ka në terren, se cilat janë gjërat që serbët në veri po mundohen ti mbrojnë! Serbët në veri do t’i rezistojnë ndryshimit”. Posaçërisht e ndjeshme do të jetë çështja e strukturave paralele, sidomos atyre të sigurisë. Disa kanë thënë se ato duhet të përfshihen në strukturat e sigurisë të Kosovës.

Çështje tjera të ndjeshme për të cilat do të vendoset në dialog përfshijnë dokumentet që do të përdoren nga votuesit në veri, listat e votuesve, regjistrimi i partive, etj. Gjithashtu, partia opozitare dhe kundërshtuese e marrëveshjeve, Partia Demokratike e Serbisë (DSS), ka pushtetin në dy komunat në veri, që në këtë rast paraqet disavantazh për partitë serbe të koalicionit qeveritar. Këta kryetarë komunash sigurisht do të jenë kundër çfarëdo marrëveshjeje. Disa kanë propozuar gjetjen e mënyrave për të përfshirë këta njerëz në dialog. Disa kanë thënë se Beogradi poashtu duhet të jetë i qarte rreth pjesëmarrjes së serbëve në zgjedhjet dhe institucionet e Kosovës dhe ta përkrahë këtë përfshirje.

Në mënyrë që tranzicioni të shkojë sa më lehtë, shumë kanë thënë se është e rëndësishme që zyrtarët serbë të mos u japin serbëve në veri porosi të kundërta. Porositë dhe mesazhet duhet t’i adresojnë brengat e tyre dhe t’u shpjegojnë atyre se interesat e tyre do të jenë të garantuara, dhe se jetërat e tyre nuk do të përkeqësohen si pasojë e marrëveshjeve. Në këtë kontekst, shumica kanë thënë se procesi i implementimit duhet të përfshijë më shumë EULEX-in dhe KFOR-in, por edhe policinë e Kosovës.

Një folës ka thënë se menjëherë pas marrëveshjes, duhet të ofrohen shërbime më të mira për serbët në veri, siç janë uji dhe energjia elektrike, si shenjë se rajoni vetëm sa do të përmirësohet. Një rekomandim tjetër ka qenë që të bëhen investime ekonomike e financiare menjëherë pas arritjes së marrëveshjes mes Beogradit e Prishtinës. Në këtë kontekst, fondi zhvillimor për veriun duhet të aktivizohet sa më shpejtë.

Në takim ka ndodhur një shkëmbim mes një pjesëmarrësi nga qeveria në Beograd dhe një pjesëmarrësi nga qeveria në Prishtinë, në lidhje me mundësitë për veprime të përbashkëta që do të merreshin nga qeveritë e tyre pas nënshkrimit të marrëveshjeve. Është propozuar që hapi i parë do të mund të ishte një vizitë e përbashkët e zyrtarëve të lartë nga ministritë e punëve të brendshme të Kosovës e Serbisë në Kosovë dhe Serbi, në ditën e njejtë, me qëllim të shfaqjes së angazhimit të tyre për implementimin e marrëveshjeve dhe normalizimin e marrëdhënieve. Shumica e pjesëmarrësve kanë përkrahur një hap të tillë.

Përfundimet dhe rekomandimet

Një numër përfundimesh e rekomandimesh kanë dalë nga kjo tryezë e rrumbullakët.

- Marrëveshjet duhet të kenë orare të arritshme të implementimit dhe afate të qarta.
- Qeveritë duhet ta informojnë publikun e tyre më detajisht rreth marrëveshjeve si dhe të punojnë për të fituar më shumë përkrahje për marrëveshjet nga popullatat dhe partitë politike në Serbi e Kosovë.
- Delegacionet e Prishtinës e Beogradit duhet të pajtohen që të mos japin deklaratë kundërshtuese rreth dialogut dhe marrëveshjeve. Nëse kjo vazhdon të ndodhë, BE-ja duhet t'i qartësojë këto deklaratë.
- Krijimi i një trupi të përbashkët të udhëhequr nga BE-ja duhet të konsiderohet me qëllim të monitorimit të implementimit të marrëveshjeve. Pjesëmarrësit nga Prishtina kanë bërë shumë të qartë se institucionet e Kosovës duhet të jenë përgjegjëse për implementimin, por Beogradi mund të ndihmojë duke ndihmuar në krijimin e një ambienti të përgjithshëm të nevojshëm për implementim, sidomos në Serbi dhe në veri të Kosovës.
- Qeveritë e Kosovës dhe Serbisë duhet të caktojnë një zyrtar të lartë, e preferueshme do të ishte një zëvendës kryeministër, që të jenë përgjegjës për implementimin nga të dyja anët.
- Prishtina dhe Beogradi duhet të organizojnë kampanja publike rreth implementimit të marrëveshjeve dhe të përfshijnë më shumë mediat dhe organizatat joqeveritare.
- Duhet të intensifikohet komunikimi mes partive politike të Serbisë e Kosovës si dhe përbrenda tyre.
- Zyrtarët e Kosovës e Serbisë duhet të organizojnë aktivitete të përbashkëta informuese, siç janë paraqitjet në media, vizita, dhe të ngrisin komunikimin mes zyrtarëve të Serbisë e Kosovës të niveleve më të ulëta. Një fillim i mirë do të ishte një vizitë publike e përbashkët në Kosovë dhe në Serbi e zyrtarëve të lartë të ministrive të punëve të brendshme.
- Marrëveshjet e arritura deri tani duhet të zbatohen në tërësi. Ka ekzistuar një pajtim i përgjithshëm se të gjitha palët duhet të jenë pjesëmarrëse aktive në implementimin e marrëveshjeve, por nuk ka pasur pajtim rreth nivelit të angazhimit. Shqiptarët insistojnë që Prishtina është akteri kryesor, kurse serbët thonë se vetëm Beogradi mund të ndryshojë mendjen e serbëve në veri dhe t'i bindë ata t'i implementojnë marrëveshjet.

- Beogradi dhe Prishtina duhet të flasin me një zë dhe t'i përfshijnë serbët në veri në procesin e implementimit si dhe t'u shpjegojnë atyre koston dhe benefitet e marrëveshjeve.
- Beogradi duhet t'i inkurajojë institucionet lokale në veri që të ndihmojnë në implementimin e marrëveshjeve dhe të organizojnë kampanja publike atje. Beogradi duhet t'i inkurajojë serbët në Kosovë dhe sidomos ata në veri që të marrin pjesë në jetën politike dhe institucionet e Kosovës.
- Duhet të bëhet e qartë se kryetarët e posazgjedhur të komunave në veri të Kosovës duhet t'i implementojnë marrëveshjet.
- Të iniciohet komunikim mes serbëve në veri dhe serbëve në jug dhe të shkëmbehen informata dhe përvoja.
- Me implementimin e marrëveshjeve, përmirësime të jetës duhet të bëhen shumë shpejtë të prekshme në veri me qëllim për të fituar përkrahje më të madhe nga popullata lokale për marrëveshjet.
- Duhet të jetë e qartë në marrëveshje se cilat struktura paralele në veri (anëtarët e forcës së mbrojtjes civile, gjykatat, asamblatë komunale, shëndëtesia, arsimiti etj.) duhet të transformohen, e cilat duhet të mbesin siç janë, si dhe mënyra se si do të ndërmerret ky proces.
- Duhet të qartësohet se cilat trupa do të jenë përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve para vendosjes së strukturave të reja, në mënyrë që të mos ketë vakuum të shërbimeve dhe sigurisë. Duhet të kërkohen modele për legjitimimin e udhëheqësisë së tanishme deri në krijimin e strukturave të reja institucionale.
- Bashkëpunimi mes serbëve në veri, EULEX-it dhe KFOR-it duhet të forcohet gjatë kohë së tranzicionit. Krijimi i sigurisë dhe luftimi i krimit të organizuar në veri janë kyç.
- Beogradi dhe Prishtina duhet të fillojnë të bashkëpunojnë me OSBE-në për përgatitjen e tranzicionit politik dhe të zgjedhjeve të ardhshme lokale në veri. Gjithashtu, nëse partitë e regjistruara në Serbi kanë në plan të marrin pjesë në zgjedhjet eventuale në veri, ata duhet të fillojnë procesin e regjistrimit në Kosovë.
- Një numër mekanizmesh duhet të krijohen para organizimit të zgjedhjeve në veri. Për shembull, është e rëndësishme që të kemi një mekanizëm funksional gjyqësor për të adresuar, mes tjerash, ankesat rreth zgjedhjeve pasi që to të kenë përfunduar.
- Komuniteti ndërkombëtar duhet të jetë garantues i marrëveshjeve, duke pasë parasysh përvorjen e marrëveshjeve të kaluara, kur ato është dashur të rinegociohen.
- Qeveria e Kosovës duhet të bëjë më shumë aktivitete informuese në veri.
- Përgjegjësitë e zyrtarëve ndërlidhës duhet të definohen qartë dhe zyrtarët duhet të krijohen sa më shpejtë që është e mundur. Përveç ndërlidhjeve politike, duhet të konsiderohet edhe krijimi i ndërlidhjeve ekonomike e tregtare.
- Nëse asnjë marrëveshje nuk arrihet, dialogu nuk duhet të deklarohet i vdekur.

Lista e Pjesëmarrësve

Vladimir Bozovic, Qeveria e Serbisë
Sadri Ferati, Lidhja Demokratike e Kosovës
Arben Gashi, Lidhja Demokratike e Kosovës
Ardian Gjini, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
Dukagjin Gorani, Qeveria e Kosovës
Adem Grabovci, Partia Demokratike e Kosovës
Adrijana Hodzic, Qeveria e Kosovës
Dhurata Hoxha, Qeveria e Kosovës
Oliver Ivanovic, Iniciativa Qytetare “Serbi, Demokraci, Drejtësi”
Dusan Janjic, Sociolog
Jadranka Joksimovic, Partia Progresive Serbe
Adriatik Kelmendi, Koha TV
Dusan Kozarev, Zyra e Presidentit të Serbisë
Leon Malazogu, Instituti Demokraci për Zhvillim
Petar Miletic, Partia e Pavarrur Liberale
Jelena Milic, Qendra për Studime Euro-Atlantike
Smiljka Milisavljevic, Universiteti në Mitrovicë
Ivana Milosavljevic, Aktiviste e të drejtave të gruas
Randjel Nojkic, Lëvizja e Ripërtirjes Serbe
Zoran Ostojic, Partia Liberal Demokrate
Stojanka Petkovic, Rajonet e Bashkuara të Serbisë
Dejan Radenkovic, Partia Socialiste e Serbisë
Nenad Radosavljevic, Rrjeti i Televizioneve serbe në Kosovës
Naim Rashiti, Grupi Ndërkombëtar i Krizave
Anamari Repic, Radio Televizioni i Kosovës
Besa Shahini, Iniciativa Evropiane për Stabilitet
Predrag Simic, Universiteti i Beogradit
Arber Vllahu, Zyra e Presidentit të Kosovës
Gordon Bardos, Këshilli poër Qeverisje Inkluzive
Didier Chassot, Departamenti Federal i Punëve të Jashtme të Zvicrës
Shpetim Gashi, Këshilli poër Qeverisje Inkluzive
Alex Grigorev, Këshilli poër Qeverisje Inkluzive
Arber Kuci, Këshilli poër Qeverisje Inkluzive
Matthew Palmer, Departamenti Amerikan i Shtetit
Alessandro Rotta, Zyra e Bashkimi Evropian në Kosovë
Norbert Ruetsche, Departamenti Federal i Punëve të Jashtme të Zvicrës
Georg Stein, Departamenti Federal i Punëve të Jashtme të Zvicrës